



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 1310/1 prot.

Tiranë, më 05.05.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi *“Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës mbi bashkëpunimin në parandalimin dhe luftën kundër krimit”*

MINISTRISË SË BRENDASHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj me nr. 12916/7 prot., datë 30.04.2025, administruar me tonën nr. 1310 prot., datë 02.05.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim, projektvendimin për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës mbi bashkëpunimin në parandalimin dhe luftën kundër krimit (në vijim *“projektvendimi”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i materialit të dërguar, vërejmë se parashikohet nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë, në kuadër të bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit, me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë për vendet palë të saj.

Ndërkohë, në germet *“a”* dhe *“g”*, të pikës 1, të nenit 3 të projektvendimit, citohet se, ndërmjet shteteve palë do të shkëmbehet informacion për fushat e bashkëpunimit, si dhe për identifikimin e personave të përfshirë në çështje penale, personat e zhdukur dhe ata të cilët, për arsye shëndetësore, moshe apo rrethana të tjera nuk japin dot informacion.

Sipas ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* (në vijim *“Ligji”*), informacioni i sipërcituar, përmban të dhëna personale, të cilat sjellin në identifikimin e subjekteve të të dhënave.

Për rrjedhojë, Zyra e Komisionerit sugjeron të merren në konsideratë këto ndryshime dhe shtesa në tekstin e projektvendimit, në mënyrë që përmbajtja e saj të jetë konform Ligjit.

Në mbështetje të parimit të përpunimit në përputhje me qëllimin, parashikuar në pikën 2, të nenit 6 të Ligjit dhe parimit të minimizimit të të dhënave, parashikuar në pikën 3, të nenit 6 të Ligjit, të cilat përcaktojnë se të dhënat personale mbledhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, si dhe duhet të kufizohen në masën që është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit ligjor, sugjerojmë që, **në germa “a” dhe “g”, të pikës 1, të nenit 3 të projektvendimit**, të përcaktohen qartë, kategoritë e të dhënave personale të nevojshme për realizimin e shkëmbimit të informacionit.

Lidhur me sa më sipër, sugjerojmë që, **fjalja e parë e pikës 2, të nenit 7 të projektvendimit**, të riformulohet me përmbajtje, si vijon:

“Kërkesat e palëve për transferimin e të dhënave personale do të tregojnë qëllimin e transferimit, sasinë dhe kategoritë e të dhënave personale që do të transferohen, afatet e ruajtjes, si dhe procedurën e përpunimit të tyre”.

Gjithashtu, sugjerojmë që, **në nenin 4 të projektvendimit, të shtohet një pikë**, me përmbajtje, si vijon:

“Kërkesat dhe shkëmbimi i informacioneve që përmbajnë të dhëna personale, do të realizohet duke përdorur mjete të sigurta komunikimi, në përputhje me legjislacionet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë”.

Në vijim, bazuar në parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, përpunimi i mëtejshëm është përpunimi i të dhënave për një qëllim tjetër, të ndryshëm nga ai fillestar, i përcaktuar në momentin e mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë transferimin ose vënien në dispozicion të të dhënave për këtë qëllim të ri.

Për këtë arsye, sugjerojmë që, **fjalja e dytë, e pikës 3, të nenit 7 të projektvendimit**, të saktësohet, me përmbajtje, si vijon:

“Palët do të transferojnë të dhëna personale vetëm për qëllimin specifik e të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, si dhe do të marrin masa që këto të dhëna nuk do të përpunohen më tej për një qëllim tjetër, që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar”.

Duke qenë se Republika e Shqipërisë ka miratuar kuadrin ligjor të përafruar me Rregulloren e Përgjithshme 2016/679 të BE për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën e BE 2016/680 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”, në kuadër të harmonizimit terminologjik e ligjor, sugjerojmë që, **pika 4, e nenit 7 të projektvendimit**, të riformulohet me përmbajtje:

“4. Palët do të garantojnë respektimin e parimit të kufizimit të ruajtjes në kohë, që nënkupton se të dhënat personale mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve

të të dhënave për një periudhë jo më të gjatë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato përpunohen”.

Në mënyrë që të unifikohet terminologjia e përdorur në përputhje me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale, sugjerojmë që, **fjalja e parë, e pikës 6, të nenit 7 të projektvendimit, të riformulohet me përmbajtje, si vjon:**

“Transferimi dhe përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale (sensitive), veçanërisht mbi origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat për shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi, do të ndalohen sipas kësaj Marrëveshjeje”.

Gjithashtu, në pikën 7, të nenit 7 të projektvendimit, fjala “pseudonimit” të zëvendësohet me fjalën “pseudonimizim” i të dhënave, si dhe termi “disproporcion”, i parashikuar në pikën 8 dhe 9/a, të projektvendimit, të zëvendësohet me togfjalëshin “të dhëna të paplota”.

Referuar pikës 5.2, të nenit 7 të projektvendimit, citohet se: “... palë e tretë nënkupton çdo person, organ, institucion, organizatë duke përfshirë ndërkombëtarët, që nuk është Palë e kësaj Marrëveshje, me përjashtim të subjektit të të dhënave personale dhe autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve palë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”.

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 70 të Ligjit, Zyra e Komisionerit, nuk është palë në këtë marrëveshje, por gëzon cilësinë e autoritetit mbikëqyrës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në Shqipëri, si dhe ka të drejtë të njihet dhe t’i vendoset në dispozicion çdo dokumentacion lidhur me transferimet, duke përfshirë datën dhe kohën e transferimit, informacionin në lidhje me autoritetin kompetent pritës, arsyetimin e transferimit dhe të dhënat personale të transferuara.

Për sa më sipër, sugjerojmë që kjo pikë të riformulohet, me këtë përmbajtje: “... palë e tretë nënkupton çdo person, organ, institucion, organizatë duke përfshirë ndërkombëtarët, që nuk është Palë e kësaj Marrëveshje, me përjashtim të subjektit të të dhënave personale”.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit, e vlerëson projektvendimin, të hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi